



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 01-060/01-25247/26

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg.

Data / Datum / Date 18.08.2026
OBILIQ - OBILIČ - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilič - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.28.07.2026, në ora 11:00 në Zyren e kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Të pranishëm ishin: Sami Ahmeti, Fjolla Nasufi, Albanë Shillova Shalaku, Vlora Mjekiqi Kabashi, Labinot Mirena, Abdyrrahman Krasniqi dhe Dorentina Krasniqi

Të pranishëm të tjerë: drejtorët komunal

Mbledhjen e udhëhoqi Sami Ahmeti, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së (29.06.2026)
3. Shqyrtimi i kërkesës së drejtorit të DEFZH – Besnik Krasniqi me nr.04-400-01-20518-26 dt.10.07.2026 për rialokimin dhe transferimin e projekteve kapitale për vitin 2026
4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Obiliqit për vitin 2025
5. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit Komunal për periudhën Janar – Qershor 2026
6. Shqyrtimi i Raportit financiar të shpenzimeve për periudhën Janar – Qershor 2026
7. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së drejtorit të DEFZH – Besnik Krasniqi me nr.04-400-01-20518-26 dt.10.07.2026 për rialokimin dhe transferimin e projekteve kapitale për vitin 2026.

Besnik Krasniqi – Ne e kemi bërë kërkesën për rialokim dhe transferim të projekteve kapitale. Këtu, janë disa projekte të cilat në institucione në Ministrinë e linjave kanë marrë leje, ndërsa një pjesë tjetër është konsultimi me drejtorin e infrastrukturës që këto mjete të barten te mallrat dhe shërbimet, shpenzime komunale dhe në subvencione.

Kryesuesi – Kishte me qenë mirë nëse, projektet e caktuara kalojnë prej buxhetit të Komunës dhe i marrin Ministrinë e linjave, është e mirë për Obiliqin dhe për qytetarët se shfrytëzohen projektet tjera. Sido që të jetë unë i lus drejtorët të jenë të përgatitur për mbledhjen e Kuvendit, të jepni përgjigje ose sqarime për pyetjet që mund të bëhen nga anëtarët e Kuvendit.

Fjolla Nasufi – Pasi që drejtori e ka përcjellë materialin edhe pse e arsyeton këtë pikë të rendit të ditës, ne ia rekomandojmë Kuvendit të Komunës.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Edhe ne jemi për atë që ti rekomandohet Kuvendit të Komunës.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, ia rekomanduan Kuvendit të Komunës shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së drejtorit të DEFZH – Besnik Krasniqi me nr.04-400-01-20518-26 dt.10.07.2026 për rialokimin dhe transferimin e projekteve kapitale për vitin 2026

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e Raportit të auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Obiliqit për vitin 2025.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, ia rekomanduan Kuvendit të Komunës shqyrtimin e Raportit të auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Obiliqit për vitin 2025.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e Raportit të punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit Komunal për periudhën Janar – Qershor 2026.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, ia rekomanduan Kuvendit të Komunës shqyrtimin e Raportit të punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit Komunal për periudhën Janar – Qershor 2026.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e Raportit financiar të shpenzimeve për periudhën Janar – Qershor 2026.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, ia rekomanduan Kuvendit të Komunës shqyrtimin e Raportit financiar të shpenzimeve për periudhën Janar – Qershor 2026.

Pika 7 e rendit të ditës

Labinot Mirena – Unë kam dhënë dorëheqje nga Komisioni i Aksionarëve NPL “Kastrioti” në mbledhjen e muajit maj dhe ju i dini procedurat se a duhet të bëhet zëvendësimi apo jo.

Kryesuesi – Mendoj se është mirë ti rekomandojmë Kuvendit lidhur me zëvendësimin e anëtarit të Komisionit të Aksionarëve NPL “Kastrioti”.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, ia rekomanduan Kuvendit të Komunës zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërrmarjes Publike Lokale “Kastrioti” SH.A. z.Labinot Mirena me një anëtar të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja përfundoi në ora 11:15

Zyrtare e lartë për punë të KK

Azize Zeneli



Kryesues i Komitetit

Sami Ahmeti